

SITUATA ME TË DREJTAT E NJERIUT – RAPORT MUJOR

MARS

20

25

SITUATA ME TË DREJTAT E NJERIUT – RAPORT MUJOR

Kjo botim u financua nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Shkup dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



KOMITETI I
HELSINKIT PËR
TË DREJTAT E
NJERIUT

PËRMBAJTJA

01

Hyrje

02

Gjuha e urrejtjes

03

Veprat nga urrejtja

04

**Dhuna në bazë
gjinore dhe dhuna në
familje**

05

Institucione të mbyllura

06

Ndihmë juridike falas

HYRJE

Më 8 Mars, me rastin e Ditës Ndërkombëtare për luftën ekonomike, politike dhe shoqërore për barazinë e grave, në Shkup u zhvillua një Marsh i organizuar nga Platforma për Barazi Gjinore dhe aktivist(e) të pavarura për të drejtat e grave. Në këtë Marsh u prezantuan disa kërkesa, e para prej të cilave kishte të bënte me drejtësi për të gjitha gratë që humbën jetën për shkak të neglizhencës sistemike dhe vrasjes së grave.

Pas tragjedisë së zjarrit në Koçani, Maqedonia e Veriut u përball përsëri me një sfidë të dyfishtë: luftën për llogaridhënie të vërtetë për jetët e humbura dhe përballjen me rritjen shqetësuese të gjuhës së urrejtjes, veçanërisht në mediat sociale dhe në disa media tradicionale. Në vend të debatit dinjitoz dhe unitetit në kërkim të drejtësisë, ne pamë fyerje, akuza politike, gjuhë urrejtjeje dhe thirrje për dhunë, të cilat u përshkallëzuan në një fushatë të rrezikshme online.

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut paralajmëroi se sulme të tilla mund të kenë pasoja serioze për lirinë e shprehjes dhe sigurinë e qytetarëve, duke kujtuar se gjuha e urrejtjes dhe thirrjet për dhunë përbëjnë vepër penale. Komiteti u bëri thirrje figurave publike, politikanëve dhe të gjithë përdoruesve të mediave sociale që të jenë të përgjegjshëm në fjalimet e tyre publike.

HYRJE

Posaçërisht vunë në dukje se tubimet paqësore të studentëve ishin cak i fyerjeve dhe spekulimeve, dhe theksoi se e drejta për tubim paqësor është një e drejtë njerëzore kushtetuese dhe e garantuar ndërkombëtarisht. Komiteti i Helsinkit kujtoi se nuk duhet të jetë çudi që të rinjtë kërkuan një luftë vendimtare kundër korrupsionit dhe padrejtësive sistematike, viktimat të të cilave ishin viktimat tragjike në Koçani, dhe autoriteteve iu bë thirrje të mos uzurpojnë zërin e tyre. Komiteti njoftoi se do të monitoronte protestat dhe do të ofronte mbrojtje ligjore falas në rast të ndonjë tejkalimi të autoritetit policor.

Njëkohësisht, Platforma e Organizatave Civile për Luftë kundër Korrupsionit shprehu ngushëllimet e thella për vdekjet tragjike në zjarrin në Koçan dhe shprehu urimet e sinqerta për shërim të shpejtë të të lënduarve. Platforma vlerësoi se zjarri ishte një tjetër shembull tragjik se si korrupsioni vret, siç u vu re më parë në tragjeditë në Laskarcë, me “Besa Trans” dhe në spitalin modular në Tetovë. Nga Platforma theksuan se korrupsioni sistematik, që zgjat prej dekadash, ende po lë pasojat e tij në jetët e njerëzve.

HYRJE

Platforma bëri thirrje për një hetim gjithëpërfshirës, të plotë, të paanshëm dhe jopartiak për zjarrin, të kryer në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme nga autoritetet kompetente. Theksuan se llogaridhënia ishte thelbësore dhe se askush nuk duhet të përjashtohet, pavarësisht nga përkatësia partiake, fetare apo etnike, ose pavarësisht nëse është ish-zyrtar apo aktual. Ata kujtuan se për më shumë se një dekadë kanë kërkuar ndryshime sistemike, të cilat, nëse do të pranoheshin, do të kishin parandaluar tragjedi të tilla.

Platforma theksoi se në kontekstin e tragjedisë në Koçan, nevojiteshin hapa urgjentë: një reformë e plotë e politikës penale për korrupsionin; përgjegjësia e institucioneve dhe kompanive për mospërmbyshjen e detyrimeve të tyre; kontrole në terren dhe jo vetëm kontrole administrative; kontrole mbi pasuritë dhe interesat e zyrtarëve që vendosin për licencat dhe lejet; forcimi i stafit dhe depolitizimi i organeve të inspektimit; rishikimin e procedurave të lëshimit të lejeve; dhe veprime të menjëhershme mbi gjetjet nga organet antikorruption dhe të auditimit.

HYRJE

Në të njëjtën kohë, Platforma theksoi se ndryshimet në ligje nuk duhet të përdoren si alibi për dështimet e kaluara dhe se llogaridhënia vertikale duhet të vendoset brenda institucioneve. Platforma bëri thirrje për t'i dhënë fund presionit mbi organizatat e shoqërisë civile, lëvizjet dhe median, të cilat shpesh ishin të parat që ngrinin alarmin për problemet në sistem.

Komiteti i Helsinkit dhe Platforma paralajmëruan se pa një hetim të plotë, drejtësi jouselektive dhe reforma të vërteta sistemike, tragjeditë do të vazhdojnë të përsëriten dhe besimi i qytetarëve në institucione do të mbetet thellësisht i lëkundur.

SITUATA ME GJUHËN E URREJTJES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - MARS 2025


Gjatë muajit shkurt në ueb platformën www.govornaomraza.mk janë regjistruar gjithsej 33 raste me elemente të gjuhës së urrejtjes, thirrjes dhe nxitjes së diskriminimit dhe ngacmimit mbi baza të ndryshme

Këtë muaj janë regjistruar 16 raste (37%) të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, 13 raste (30%) në bazë të kombësisë, 7 raste (16%) në bazë të përkatësisë seksuale, 4 raste (8%) në bazë të gjinisë dhe seksit dhe 3 raste (6%) në bazë të bindjeve politike.

Gjatë muajit mars, vazhdoi trendi i një numri në rritje të raportimeve që lidhen me përkatësinë kombëtare dhe etnike, dhe diskursi u zhvendos nga kritika ndaj ngjarjeve aktuale në vend në gjuhë urrejtjeje. Përveç fyerjeve dhe nënçmimeve të ndërsjella, shkelja e heshtjes njëminutëshe për t'i bërë homazh viktimave të Koçanit nga grupi i tifozëve "Balistët" në fillim të ndeshjes futbollistike Shkëndija kundër Brerës në Tetovë kontribuoi më tej në rritjen e gjuhës së urrejtjes. Për këtë ngjarje, Komiteti i Helsinkit ngriti një kallëzim penal në Ministrinë e Brendshme për nxitje të urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike.

Këtë muaj në rrjetet sociale është regjistruar fjalim shqetësues për shkak të bindjeve politike ndaj aktivistëve të lëvizjes civile "Kush e ka radhën" në njoftimet për tubime dhe protesta publike me rastin e tragjedisë në Koçan, ku humbën jetën 62 persona.

PARAQITJA GRAFIKE E SITUATËS ME GJUHËN E URREJTJES NË MARS TË VITIT 2025



***Platforma regjistroi 33 raste origjinale të gjuhës së urrejtjes - në disa raste, u regjistruan më shumë se një karakteristikë mbrojtëse.**

SITUATA ME GJUHËN E URREJTJES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - MARS 2025

PËRFUNDIME:

Përfundime:

Numri më i madh i rasteve të gjuhës së urrejtjes lidhet me përkatësinë etnike dhe kombëtare, gjë që tregon tensione të thella etnike në shoqëri, veçanërisht në kontekstin e ngjarjeve të ndjeshme, siç është tragjedia në Koçan.

Nga kritika politike ose shoqërore, gjuha e urrejtjes kalon lehtësisht në shprehje diskriminuese dhe ngacmuese, gjë që tregon ndërgjegjësim të pamjaftueshëm publik dhe mungesë mekanizmash efektive për të parandaluar fenomene të tilla në rrjetet sociale dhe në tubime publike.

SITUATA ME GJUHËN E URREJTJES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - MARS 2025

REKOMANDIME:

Rekomandime:

Është e nevojshme të forcohen mekanizmat për parandalimin dhe sanksionimin e gjuhës së urrejtjes, veçanërisht përmes veprimeve më të shpejta dhe më efikase nga institucionet (si policia dhe prokuroria) pas raportimeve për gjuhën e urrejtjes.

Është e nevojshme të organizohen fushata për të rritur ndërgjegjësimin publik, me fokus në edukimin rreth dëmit të gjuhës së urrejtjes dhe promovimin e një kulture dialogu, veçanërisht në kontekstin e ngjarjeve tragjike që mund të keqpërdoren lehtësisht për të përhapur urrejtje.

SITUATA ME VEPRAT NGA URREJTJA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - MARS 2025

Gjatë muajit mars 2025, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka regjistruar 3 incidente të mundshme me motive të njëanshme, në pjesën më të madhe, në përputhje me treguesit e tjerë (vendndodhja, mënyra e ekzekutimit, përfshirja e të miturve dhe nxënësve të shkollave të mesme etj.), ekziston bindja e arsyeshme se ato janë kryer për shkak të përkatësisë etnike të viktimës, gjegjësisht autorit.

Konkretisht, po flasim për 2 incidente të mundshme bazuar në përkatësinë etnike dhe një incident bazuar në besimin fetar. Sipas llojit të dhunës, incidentet përmbajnë dhunë dhe përdhosje të simboleve. Në dy nga rastet, të miturit shfaqen si viktima ose autorë.

Incidentet e mundshme janë përfshirë në raport sepse ato lidhen me situata ku tregues të tjerë sugjerojnë se ka arsye për të besuar se këto incidente janë të motivuara nga njëanshmëria.

Ndër këta tregues të njëanshëm janë: perceptimi i viktimës/dëshmitarit; komentimi në vendin e ngjarjes; dallimi ndërmjet viktimës dhe dhunuesit në bazë etnike; modeli/frekuenca e incidenteve të mëparshme; natyra e dhunës; mungesa e motiveve të tjera; si dhe vendi dhe koha.

SITUATA ME VEPRAT NGA URREJTJA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - MARS 2025

Thënë më saktë, incidentet e mundshme janë përfshirë në këtë raport për shkak të informacionit të marrë në lidhje me vendndodhjen (shembull: lagje ose shkolla etnikisht e përzier, linjat e autobusëve të përdorura nga anëtarë të komuniteteve të ndryshme etnike, vendet ku në të kaluarën kanë ndodhur vepra penale të urrejtjes), llojin (shembull: një grup më i madh në numër i personave të mitur që sulmojnë një ose më shumë viktima pa ndonjë provokim, përleshje grupore, sulme të mëparshme në autobus apo stacion autobusi), koha (shembull: pas përplasjeve të mparshme si formë hakmarrjeje, pas lëshimit nga shkolla, gjatë ose pas një ndeshjeje sportive), dhe prona e dëmtuar gjatë kohës së incidentit (shembull: vendet e ceremonive fetare).

SITUATA ME VEPRAT NGA URREJTJA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - MARS 2025

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIM

Përfundime:

Në mars të vitit 2025 janë regjistruar 3 incidente të mundshme me motive të njëanshme, nga të cilat 2 kanë qenë të motivuara etnike, dhe 1 me motive fetare. Të miturit në më shumë se gjysmën e incidenteve dhe dhuna ndodh në vende publike.

Rekomandime:

Përmirësimi i identifikimit të motivit të njëanshmërisë në incidentet e urrejtjes.

Parandalimi dhe edukimi për të reduktuar dhunën, veçanërisht tek të rinjtë.

SITUATA ME DHUNËN ME BAZË GJINORE DHE DHUNËN NË FAMILJE, RAPORT MUJOR - MARS 2025

Gjatë muajit mars të vitit 2025, tetë gra viktima të dhunës me bazë gjinore dhe në familje iu drejtuan Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, kurse bashkëpunëtorët në terren ofruan ndihmë paraligjore në 23 raste. Rastet u regjistruan në komuna të ndryshme, si Tetova, Strumica, Shtipi, Shkupi etj.

Në pjesën më të madhe, gratë përballeshin me dhunë fizike, psikologjike dhe ekonomike, si dhe probleme me divorcin, mbështetjen financiare për fëmijët dhe ndarjen e pronës. Viktimat shpesh ndodhen në situata ku mbështetja institucionale nuk është e disponueshme për ta ose nuk ndihen të inkurajuar për të raportuar dhunën. Disa prej tyre janë gra të moshuara që kanë jetuar nën kontroll dhe poshtërim për dekada, ndërsa të tjera janë nëna të reja që përpiqen të mbrojnë fëmijët e tyre nga një prind abuziv. Janë regjistruar edhe raste kur viktimat nuk kanë mundur të rregullojnë statusin e fëmijëve të tyre për shkak të marrëdhënieve të pazgjidhura martesore, gjë që i marginalizon më tej këto gra dhe fëmijët e tyre.

Përmes punës në terren, u ofrua informacion bazë ligjor, mbështetje në mbledhjen e dokumentacionit, përgatitje për paraqitjen e kërkesave për mbrojtje dhe referim te institucionet dhe organizatat përkatëse për mbështetje psikologjike dhe sociale.

SITUATA ME DHUNËN ME BAZË GJINORE DHE DHUNËN NË FAMILJE, RAPORT MUJOR - MARS 2025

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIM

Përfundime:

Ekziston një nevojë e vazhdueshme për një qasje në terren, sepse disa viktimat jetojnë në mjedise të izoluar nga ana sociale dhe nuk kanë qasje në institucione. Dhuna me bazë gjinore shpesh mbetet e paraportuar për shkak të frikës, mosbesimit në sistem dhe varësisë ekonomike nga autorët e krimit.

Rekomandime:

Forcimi i kapaciteteve të institucioneve lokale (si p.sh. QPS-të, policia, ndihma ligjore) me fokus në rritjen e ndërgjegjësimit rreth dhunës me bazë gjinore. Organizimi i aktiviteteve edukative dhe mbështetëse në komunitetet rurale dhe të marginalizuara, duke përfshirë komunitetin në identifikimin dhe parandalimin e dhunës.

SITUATA ME INSTITUCIONET E MBYLLURA, RAPORT MUJOR - MARS 2025

Pasqyrë e përgjithshme e aktiviteteve

Gjatë muajit mars 2025, Komiteti i Helsinkit ka ofruar ndihmë juridike falas për personat e dënuar në katër raste.

- Dy raste: Pezullimi i dënimit.
- Një rast: Lirim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse.
- Një rast: Transferim në një institucion tjetër ndëshkimor-korrektues.
- Një rast: Mbrojtje shëndetësore për shkak të ofrimit të pamjaftueshëm të kujdesit mjekësor në një institucion ndëshkimor-korrektues.

Pasqyrë e shkurtër e shërbimeve juridike të ofruara

- Rishikimi i legjislacionit dhe këshillave ligjore të ofruara mbi lirin me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse.
- Kërkesa për qasje të lirë në informacione dorëzuar institucioneve kompetente.
- Ofrimi i informacionit dhe këshillave ligjore për klientët.

SITUATA ME INSTITUCIONET E MBYLLURA, RAPORT MUJOR - MARS 2025

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIM

Përfundime dhe Rekomandim:

Zhvillimi i planeve individuale të rehabilitimit që marrin në konsideratë nevojat specifike të secilit të burgosur, veçanërisht për rastet e lirimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse dhe transferimit.

Përmirësimi i kushteve për kujdes mjekësor duke ofruar personel mjekësor të kualifikuar, kontrole të rregullta shëndetësore dhe mekanizma efikasë për raportimin dhe zgjidhjen e problemeve shëndetësore.

Forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies në institucionet ndëshkimore*korrektuese me qëllim promovimin e respektit për të drejtat e njeriut dhe aksesin në drejtësi për personat e dënuar.

NDIHMË JURIDIKE FALAS, RAPORT MUJOR - MARS 2025 TË DHËNA STATISTIKORE

NJF	30	
NJD	0	Përqindja
Gjithsej	30	
	Numri	Përqindja
Gjinia		
Meshkuj	23	76,5
Femra	7	23,5
Përkatësia etnike		
Maqedonë	21	70
Shqiptarë	3	10
Romë	5	16,5
Boshnjakë	1	3,5
Rajone gjeografike		
Shkup	20	67
Vardar	2	6,5
Pollog	1	3,5
Pellagoni	2	6,5
Jugperëndim	2	6,5
Verilindje	2	6,5
Lindje	1	3,5
Juglindje	0	0

NDIHMË JURIDIKE FALAS, RAPORT MUJOR – MARS 2025 TË DHËNA STATISTIKORE

Fusha juridike	Numri	Përqindja
E drejta pronësore	6	20
Mbrojtja dhe sigurimi social	2	6,5
Mbrojtja e fëmijëve	1	3,5
Sigurimi pensional dhe invalidor	0	0
Mbrojtja dhe sigurimi shëndetësor	0	0
Marrëdhëniet e punës	5	16
Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje	1	3,5
Çështje statusore	1	3,5
Mbrojtja e të drejtave të njeriut	7	23,5
Të tjera	7	23,5

RAST STUDIMI - PARREGULLSI NË PROCEDURAT PËRMBARIMORE KUNDËR DEBITORËVE ME TË ARDHURA NËN PAGËN MESATARE

Në mars të vitit 2024, Komitetit të Helsinkit me kërkesë për ndihmë juridike falas iu drejtuan dy debitorë të cilët detyrohen të arkëtojnë borxhin e tyre përmes dy përmbaruesve të ndryshëm.

Siç mund të shihet nga urdhrat e lëshuar dhe deklaratat e llogarisë bankare, edhe pse të ardhurat e debitorëve janë shumë më afër pagës minimale, atyre prapëseprapë u bëhen zbritje në shumën prej 1/3 të pagës së tyre.

Ky veprim i përmbaruesve është në kundërshtim me nenin 117 të Ligjit për përmbarim (me nëntitull: kufizimi i përmbarimit), i cili parashikon se debitorët me pagë ose pension më të ulët se paga mesatare, përmbarimi do të kryhet me mbajtjen e 1/5 të pagës ose pensionit.

Deri në fund të muajit, njëri nga përmbaruesit e kishte njoftuar Komitetin e Helsinkit se ishte bërë një gabim, domethënë se ishte bërë një korrigjim në urdhër, ndërkohë që ende nuk ishte marrë asnjë njoftim nga përmbaruesi tjetër.

RAST STUDIMI - PARREGULLSI NË PROCEDURAT PËRMBARIMORE KUNDËR DEBITORËVE ME TË ARDHURA NËN PAGËN MESATARE

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIM:

Qytetarët me të ardhura afër pagës minimale hyjnë në kategorinë e qytetarëve të varfër, të cilët mbroreshin më tej me ndryshimet në Ligjin që parashikonte kufizimin e përmbarimit bazuar në shumën e të ardhurave. Megjithatë, ndoshta për shkak të presionit nga kreditorët për të mbledhur borxhin më shpejt ose për shkak të neglizhencës së agjentëve përmbarues, në praktikë, lëshohen dhe zbatohen urdhra përmbarimi në kundërshtim me nenin 117 të Ligjit për Përmbarimin. Një sjellje e tillë është e papranueshme dhe përfaqëson një shfrytëzim të injorancës ligjore të qytetarëve, të cilët nuk janë të vetëdijshëm për kufizimet e zbatimit dhe as nuk kërkojnë ndihmë ligjore falas. Duke marrë parasysh shkallën e këtij problemi, nëse qytetarë të tjerë na drejtohen me të njëjtin problem, Komiteti i Helsinkit do t'i parashtrejtojë një ankesë Dhomës së Përmbaruesve.
